

Kryesore

Erasmus+ për zhvillimin e administratës publike përmes kurrikulave



Publikuar në : 08:51 - 30/08/19 [V Liberales](#)

Me anë të projektit FINAC u bë e mundur hapja e Masterit Profesional në Audit, me fokus për punonjësit e administratës publike, ku u mundësuan 25 bursa studimi në vitin akademik 2018-2019, të financuara përmes skemës Erasmus+

U mbajt dje në UET tryeza finale e rrumbullakët e projektit “Menaxhimi Financiar, Kontabiliteti dhe Kontrolli – Zhvillimi i Kurrikulave për Ngritjen e Kapaciteteve të Administratës Publike” (FINAC), i financuar nga Bashkimi Europian, Programi Erasmus+ Zhvillim i Kapaciteteve në Arsimin e Lartë. UET mirëpriti përfaqësues nga Universiteti i Beogradit, si edhe nga Zyra Kombëtare Erasmus+ në Shqipëri për të ndarë me ta arritjet e këtij projekti tre vjeçar. Produkti final i projektit është hapja e Masterit Profesional në Audit me fokus për punonjësit e administratës publike në Universitetin Europian të Tiranës në vitin akademik 2018-2019. Në kuadër të projektit, UET ofroi 25 bursa studimi në vitin akademik 2018-2019, të financuara

përmes skemës Erasmus+ për punonjës të administratës publike në fushën e auditit, menaxhimit financiar, kontrollit, administrimin publik dhe menaxhimin e projekteve.

Presidenti i UET, Prof. Selami Xhepa, mirëpriti delegacionin e Universitetit të Beogradit dhe theksoi qasjen ndërkombëtare të universiteteve në zhvillimin e programeve studimore, kërkimit dhe bashkëpunimit. Ndërkohë, drejtuesja e Zyrës Kombëtare Erasmus+ në Shqipëri, Znj. Aida Breti vlerësoi arritjet e projektit dhe kontributin e tij për shoqërinë në tërësi, dhe jo vetëm për administratën publike apo universitetet. Ajo inkurajoi bashkëpunimin e më tejshëm, jo vetëm mes universiteteve, por edhe zgjerimin e bashkëpunimit me aktorë të tjerë në shoqëri. Prof. Sladjana Benković, drejtuesja e projektit nënvizoi, se përgjatë zbatimit të projektit ka pasur vështirësi sidomos në hapjen, licensimin dhe akreditimin e programeve Master në Shqipëri dhe Serbi, por përmes kapërcimit të tyre u përforcua edhe më tej, jo thjesht bashkëpunimi i frytshëm, por edhe miqësia. Bashkëpunimi mes Universitetit të Beogradit dhe UET do të thellohet më tej përmes shkëmbimeve të stafit dhe të studentëve, iniciativave për zhvillim projektesh për arsim më cilësor dhe kurrikula ndërkombëtare.



Master Profesional për Audit në UET i mundësuar nga projekti FINAC

Në këtë kuadër të projektit FINAC Erasmus+, Univesiteti European i Tiranës ka zhvilluar një master të ri, Masterin Profesional në Audit, i licensuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 684, datë 12 tetor 2018. 25 bursa u akorduan për punojnësit e administratës publike. Njëkohesisht, Masteri tërhoqi edhe interesin e sektorit privat dhe atij bankar. Projekti në UET është drejtuar nga Dr. Blerjana Bino. Përmes tij janë trajnuar dhe kanë përfituar nga mobilitetet me universitetet partnerët në Itali, Çeki, Kroaci, Serbi, pedagogët e Departamentit të

Manaxhimit, Departamentit të Financës, Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave, Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrës së Projekteve dhe Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë.

Në vitin e parë të projektit, kërkuesit dhe profesorët e UET kanë realizuar një studim të nevojave të administratës publike sa i takon menaxhimit financiar, auditit dhe kontrollit. Sipas këtij studimi rezultoi, që ka nevoja në rritje për zhvillim kapacitetesh në administratën publike për të përmirësuar më tej procedurat e menaxhimit financiar, auditit dhe kontrollit të brendshëm në linjë me standardet europiane dhe me synim rritjen e llogaridhënies dhe transparencës. Më konkretisht u evidentuan nevojat kryesore të funksionimit të sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (KBFP/PIFC) në administratën publike. Këto nevoja shërbyen më pas si baza e hartimit të programit për masterin e ri në kuadër të projektit FINAC të programit Erasmus+ , që UET përgatiti në vitin e dytë të projektit.

Gjithashtu, në nëntor dhe dhjetor të vitit 2018, UET realizoi trajnime të dedikuara për punonjësit e administratës publike në fusha të identifikuara si të nevojshme gjatë studimit të bërë në vitin e parë: IT Audit, menaxhimi dhe kontrolli i performancës, kontrolli dhe auditimi i brendshëm dhe financat publike. Këto trajnime realizohen nga profesorët dhe kërkuesit e UET, si edhe nga ekspertët më të mirë të fushës.

Çfarë është projekti FINAC

UET është partner në projektin Erasmus+ “Menaxhimi Financiar, Kontabilitet dhe Kontrolli – Zhvillimi i Kurrikulave për Ngritjen e Kapaciteteve të Administratës Publike” (FINAC), i financuar nga Bashkimi Europian, Programi Erasmus+ Zhvillim i Kapaciteteve në Arsimin e Lartë me kohëzgjatje 15 tetor 2016 – 14 tetor 2019. Fokusi kryesor i këtij projekti është të japi një kontribut për të rritur cilësinë e buxhetimit, menaxhimit të parasë, menaxhimit financiar, kontabilitetit dhe kontrollit në Administratën Publike në Shqipëri dhe Serbi. Objektivat specifike të këtij projekti janë: (i) të hartojë dhe zhvillojë tre programe të reja masteri në Serbi dhe dy programe të reja masteri në Shqipëri në fushat e menaxhimit financiar, kontabilitetit dhe kontrollit në Administratën Publike në Shqipëri dhe Serbi; (ii) të ofrojë trajnime në Qendrat Universitare/Institute për punonjësit e Administratës Publike në Serbi e Shqipëri; (iii) Modernizimi i njërës prej programeve master në fushën e Menaxhimit Financiar Publik në Serbi.

/Gazeta Liberale